

VENDIM
Nr. 81, datë 4.5.2020

**MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ALPIQ ENERGY ALBANIA”
SHPK, NR. 290, SERIA T15, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË
ERE-s NR. 72, DATË 13.5.2015**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 13 dhe nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, dhe nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.5.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Mbikëqyrjes dhe Autorizimeve lidhur me “Rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Alpiq Energy Albania’ sh.p.k., nr. 290, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 72, datë 13.5.2015”, si dhe informacionin shtesë nr. 50/1-1 prot., datë 30.4.2020,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 53, datë 26.3.2020, filloi procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, nëpërmjet postës elektronike zyrtare është kryer njoftimi në medien e shkruar me komunikimin elektronik të datës 26.3.2020 dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezulton të ketë vërejtje apo ankesa nga palë të treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Alpiq Energy Albania” sh.p.k.

- Nëpërmjet postës elektronike zyrtare, të datës 30.3.2020, shoqërisë i është dërguar shkresa për njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës dhe kërkesa për plotësimin e dokumentacionit të munguar, i cili konsistonte në:

- dokumentacionin e përgjithshëm: neni 16, pika 1, germa “b”;
- dokumentet juridike, administrative dhe pronësore: neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “d”, “e”;
- dokumentet financiare dhe fiskale: neni 9, pika 3, germa “c”;
- dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike: neni 9, pika 4.8, gjerat “a”, “b”, “c”.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., me komunikimin elektronik të datës 7.4.2020, ka përcjellë në ERE pjesërisht dokumentacionin e munguar.

- Me shkresën nr. 552/6 prot., të ERE-s, datë 30.4.2020, është përcjellë nga shoqëria “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., vërtetimi i prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me anë të të cilit vërtetohet se nuk ka procedim penal në ngarkim të administratorëve të shoqërisë.

- Rezulton që shoqëria ka aplikuar brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., në bazë të nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien,

modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, rezulton si më poshtë:

- dokumentacioni i përgjithshëm: neni 16, pika 1, germa “a” – plotësuar;
- formati i aplikimit: neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c” – plotësuar;
- dokumentet juridike, administrative dhe pronësore: neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “e” – plotësuar;
- dokumentet financiare dhe fiskale: neni 9, pika 3, germa “a”, “b”, “c”, “d” – plotësuar;
- dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike: neni 9, pika 4.8, gjerat “a”, “b”, “c” – plotësuar;
- pagesa e aplikimit dhe pagesa e rregullimit: neni 16, pika 7 – plotësuar;
- vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë: neni 9, pika 2, germa “d” - plotësuar pjesërisht. Janë depozituar në ERE vërtetimet e prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për administratorët e shoqërisë.
- Në lidhje me kërkesën e neni 9, pika 2, germa “d”, që lidhet me vërtetimin nga gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë, në bazë të pikës 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 51, datë 26.3.2020, “Mbi disa ndryshime të përkohshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit COVID-19 dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë”, shoqëria do të mund ta plotësojë këtë kërkesë të rregullores brenda një muaji nga përfundimi i gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë, për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 290, seria T15, të shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, data 13.5.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 14.5.2020.

2. Shoqëria të plotësojë kërkesën e neni 9, pika 2, germa “d”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, brenda një muaji nga përfundimi i gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shpallur me vendimin e Këshillit të Ministrave.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti